

## **Statuti**

### **i Shoqatës "ALBANIAN INSTITUTE OF INTERNAL AUDITORS "**

"Bazuar në Legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, në veçanti Ligji Nr. 8788 datë 07. 05. 2001; "Për Shoqatat Jofitimprurëse" dhe Ligji Nr. 8789 datë 07. 05. 2001 "Për Regjistrimin e Shoqatave Jofitimprurëse":

#### **Ne, Anëtarët themelues të kësaj shoqate;**

në Mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme

#### **miratuar këtë statut si më poshtë vijon:**

### **KREU I**

#### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 – Qëllimi**

"Albanian Institute of Internal Auditors", më poshtë quajtur " Instituti", është një bashkim vullnetar që ka për qëllim zhvillimin e profesionit të auditimit të brendshëm dhe kulturën e kontrollit të brendshëm në Shqipëri. Gjithashtu, ajo ka për qëllim të ndërtojë një platformë të dedikuar edukimit dhe progresit të audituesve të brendshëm dhe individëve të ndryshëm të interesuar në praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.

Me anë të veprimtarisë së tij, Instituti synon të promovojë vlerën dhe rëndësinë e auditimit të brendshëm në sektorin privat dhe atë publik.

Misioni i Institutit është të nxisë evidentimin, njohjen dhe vlerësimin e auditimit të brendshëm nëpërmjet:

- Shpërndarjes dhe komunikimit të një Kodi Etike dhe të Standardeve efikase profesionale, që përbëjnë pika referimi të vlefshme dhe të sigurta për gjithë profesionin;
- Kërkimit, nxitjes dhe shpërndarjes së njohurive dhe informacioneve lidhur me Auditimin e Brendshëm, Qeverisjen e Organizatës, Administrimin e Rrezikut dhe Kontrollin e Brendshëm,;
- Realizimit të formimeve profesionale të audituesve të brendshëm nëpërmjet organizimit të kurseve të trajnimit profesional me njohuri bazë, nëpërmjet seminareve me nivel të avancuar studimesh të thelluara si dhe nëpërmjet publikimit të materialeve të përshtatshme informative;
- Promovimit, shpërndarjes dhe vlerësimit të formave më të përshtatshme të arritjes së profesionalizimit, që kanë për qëllim të sigurojnë nivelin drejtues të një organizate dhe gjithë palëve të interesuara lidhur me të, elementët e duhur për të vlerësuar nëse personi që ka përgjegjësinë e audituesit të brendshëm zotëron nivelin e duhur të aftësive dhe njohurive profesionale. Midis këtyre formave të

vlerësimit, prioritet i jepet certifikimit ndërkombëtar në auditimin e brendshëm *Certified Internal Auditor (CIA)* si dhe certifikimeve të tjera ndërkombëtare në këtë fushë të ofruara po nga Instituti i Audituesve të Brendshëm (IIA), si *Control Self-Assessment (CCSA)*, *Government Auditing (CGAP)*, si dhe *Certified Financial Services Auditor (CFSA)*.

## **Neni 2 – Forma e Institutit**

“Albanian Institute of Internal Auditors” është organizuar në formën e një shoqate jofitimprurëse, joqeveritare dhe jopolitike, e cila ushtron veprimtarinë e saj në mënyrë të pavarur.

## **Neni 3 - Vula dhe Stema e Institutit**

Instituti ka vulën dhe stemën e tij të veçantë e cila do të identifikojë çdo dokument që i përket Institutit. Ato janë të pranishme në çdo dokument, korrespondencë, certifikatë, vërtetim anëtarësie apo çdo produkt tjetër intelektual e administrativ të “prodhuar” nga Instituti.

## **Neni 4 - Strategjia e ndërhyrjes**

Strategjia e ndërhyrjes së Institutit bazohet në tre drejtime kryesore:

- Puna në rrjet;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve;
- Organizimi efikas në sektorët e ndërhyrjes.

Të gjitha veprimet e Institutit mund të kryhen në bashkëpunim me komunitetet, agjencitë përkatëse shtetërore dhe Instituti kombëtare e ndërkombëtare.

## **Neni 5 – Veprimtaria Ekonomike**

Instituti mund të ushtrojë dhe veprimtari ekonomike pa qenë nevoja që të krijojë një subjekt të veçantë për qëllimet dhe synimet e saj, me kusht që kjo veprimtari të jetë në përputhje me qëllimet e Institutit dhe të ardhurat e saj të përdoren për përmbushjen e qëllimeve të përcaktuara në këtë statut dhe jo për qëllime fitimi.

## **Neni 6 – Objektivat**

Objektivat e Institutit janë të ndarë si më poshtë:

- 1) Të promovojë vlerën e shtuar që auditimi të brendshëm i jep organizatës përkatëse;
- 2) Të japë edukim profesional dhe mundësi zhvillimi; standarde dhe udhëzime mbi praktikat profesionale; dhe programe certifikimi;

- 4) 3) Të përhapë dhe të promovojë njohuri mbi auditimin e brendshëm dhe sidomos përsa i përket rolit që ka ai në qeverisje, në menaxhimin e riskut dhe në sistemin e kontroleve të brendshme;
- 5) Të edukojë praktikantët dhe audienca të tjera mbi praktikat më të suksesshme të auditimit të brendshëm;
- 6) Të krjojë një platforme komunikim dhe ndërveprimi për audituesit e brendshëm nga të gjithë vendet si dhe me organizata profesionale te ngjashme për të shkëmbyer informacion dhe eksperiencia.

## **Neni 7 – Mjetet**

Mjetet me të cilat Instituti do të realizojë qëllimin dhe objektivat e saj janë si më poshtë:

1. Fushata ndërgjegjësimi mbi rëndësinë e auditimit të brendshëm si një funksion kyç në mekanizmat e qeverisjes së organve private dhe atyre publike, duke dhënë siguri në:
  - efektshmërinë e operacioneve;
  - besueshmërinë e raportimeve financiare
  - zbulimi dhe hulumtimi i mashtrimeve;
  - ruajtja e aseteve dhe përputhshmëria me ligjet dhe rregulloret.
2. Grumbullimi, përkthimi, botimi, ribotimi dhe shpërndarja e literaturës në fushën e auditimit të brendshëm, sistemeve të kontrollit, menaxhimit të riskut, sistemet e menaxhimit të informacionit, qeverisjes së korporatave, menaxhimit të projekteve dhe mbi subjekte të tjera të lidhur me fushat në fjalë;
3. Lobim pranë institucioneve dhe personave me influencë për mbështetje apo/dhe nxitjes së ushtrimit të profesionit të auditimit të brendshëm në pajtim me përkufizimin, standardet, kodin e etikës të Institutit.
4. Kontakte të vazhdueshme me rrjete kombëtare dhe ndërkombëtare që veprojnë në fushën e auditimit të brendshëm, sistemeve të kontrollit, menaxhimit të riskut, sistemet e menaxhimit të informacionit, qeverisjes së korporatave, menaxhimit të projekteve dhe mbi subjekte të tjera të lidhur me fushat në fjalë;
5. Bashkëpunim me institucionet shtetërore dhe private për implementimin e programeve të ndryshme në mbështetje të auditimit të brendshëm;
6. Trajnimi i stafit të Institutit dhe organizimi i seminareve e takimeve për të shkëmbyer eksperiencat me Instituta të tjera brenda dhe jashtë vendit;
7. Nxjerrja e publikimeve për të pasqyruar veprimtarinë e Institutit;
8. Krijimi i grupeve të punës me specialistë të kualifikuar për implementimin e projekteve që do të zhvillohen për arritjen e qëllimit të Institutit;
9. Çdo lloj aktiviteti tjetër që do të jetë në dobi dhe mbështetje të qëllimit dhe misionit të Institutit, si dhe konform legjislacionit shqiptar ne fuqi.

## **Neni 8 – Ndalimi i shpërndarjes së përfitimeve**

Të ardhurat nga aktiviteti i ligjshëm i Institutit do të përdoren ekskluzivisht për zhvillimin dhe kohëzgjatjen e objektivave të kësaj Institutit.

Nuk lejohet asnjë formë e shpërndarjes së përfitimeve sociale ose e përfitimit financiar dhe material nga të ardhurat dhe fitimet e Institutit prej personave që janë subjekte të statutit dhe aktit themelues. Këtu përjashtohen detyrimet në formën e pagave, rrogave, shpërblimeve dhe kompensimeve që rrjedhin nga kontrata e punës ose kontrata të tjera të ngjashme me të ose mbulimi i shpenzimeve të kryera me porosi dhe për llogari të Institutit kur kjo është e mundur dhe në varësi të gjendjes ekonomike të Institutit. Çdo akt tjetër do të konsiderohet juridikisht i pavlefshëm.

## **Neni 9 – Ushtrimi i Aktivitetit**

Institutite ushtron veprimtarinë e saj brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Instituti, me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, hap Degë në çdo Qark, Bashki ose Komunë. Degët e hapura nuk mund të kryejnë asnjë veprim pa marrë paraprakisht me shkrim miratimin e Bordit Drejtues të Institutit.

Institutita, me Vendim të Asamblesë së Përgjithshme, mund të hapë degët e tij edhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, duke zbatuar legjislacionin përkatës të vendit ku do të hapet Dega.

## **Neni 10 – Kohëzgjatja e aktivitetit**

Instituti e ushtron veprimtarinë e tij në një kohëzgjatje të pacaktuar.

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë një afat të përcaktuar për ushtrimin e veprimtarisë së Institutit me shumicën e kërkuar dhe sipas procedurës për ndryshimin e statutit.

## **Neni 11 – Selia**

Instituti do të ketë selinë e tij qendrore në Tiranë në adresën: Rr:"Vaso Pasha", P:23, Shk:2, Ap:9. Adresa mund të ndryshohet me vendim të Bordit Drejtues të Institutit.

## **KREU II**

### **ANËTARËSIA**

#### **Neni 12 – Kriteret e Anëtarësimit**

Anëtar i Institutit mund të bëhet çdo person fizik ose juridik i cili:

1. Është mbi 18 vjeç
2. Pranon të punojë për realizimin e qëllimeve dhe programit të Institutit.
3. Pranon statutin dhe rregulloren e brendshme të këtij Instituti.

Për pranimin në këtë Institut, nuk bëhet ndonjë dallim nga gjendja sociale, kombësia, raca, feja, dhe seksi.

Anëtarët ndahen sipas kategorive të mëposhtme:

- Anëtarë aktivë;
- Studentë ;
- dhe Anëtarë nderi.

Konsiderohen anëtarë aktivë të gjithë ata anëtarë që kryejnë ose kanë kryer aktivitet në fushën e auditimit të brendshëm, këshillimit dhe vlerësimit mbi kontrollin e brendshëm, si pjesë e brendshme e një organizate apo nga jashtë saj, qoftë në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat.

Konsiderohen anëtarë studentë, të gjithë ata që janë të angazhuar pranë Universiteteve. apo Institucioneve të tjera akademike apo shkollore, në studimin e aktivitetit të auditimit të brendshëm apo të tematikave të tjera mbi kontrollin e brendshëm që nuk përfshihen në kategoritë e mëparshme. Konsiderohen anëtarë nderi, ata anëtarë që, në gjykimin dhe me vendim të Bordit Drejtues, me aderimin e tyre në Institutit mund të mbështesin zhvillimin e aktivitetit të Auditimit të brendshëm qoftë edhe si përfaqësues të fushës ekonomike, financiare apo akademike.

Anëtarët e pranuar në kategorinë Anëtar aktiv, do të ruajnë këtë status edhe në rast ndryshimi të mëvonshëm të aktivitetit profesional.

Çdo anëtarësim nënkupton rinovimin e statusit çdo vit, përveç rasteve kur komunikohet e kundërta nga vetë anëtari, komunikim i cili duhet kryer brenda datës 30 Shtator të vitit në vazhdim.

Statusi "anëtar" është një cilësi personale dhe e patransferueshme. Kuotat e anëtarësimit janë të patransferueshme dhe të panegociueshme.

Nuk pranohen si anëtarë të Institutit ata të cilët më parë kanë marrë pjesë në aktivitete në dëm të Institutit dhe qëllimeve të tij, si dhe persona që janë përjashtuar nga anëtarësia sipas dispozitave të Statutit dhe Rregullores.

### **Neni 13 – Procedurat e Pranimit**

Çdo person që dëshiron të bëhet anëtar i Institutit, me përjashtim të statusit Anëtar nderi, plotëson formularin e anëtarësimit të hartuar nga Bordi Drejtues, si dhe një deklaratë me shkrim, me anë të së cilës ai pranon të punojë për realizimin e qëllimit, statutit, akt-themelimit dhe rregulloreve të Institutit.

Në rast se anëtarësimi i tij nuk pranohet, personi ka të drejtë të ankohet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **Neni 14 – Heqja dorë nga anëtarësimi**

Anëtarët mund të heqin dorë nga anëtarësia në Institut (largohen) në çdo kohë, duke paraqitur një letër largimi drejtuar Kryetari i Bordit, i cili më pas kryen procedurat për fshirjen e emrit nga regjistri i anëtarëve.

Në rastin e heqjes dorë, anëtarësia pushon në momentin e çregjistrimit nga regjistri i anëtarëve. Detyrimi për pagimin e kuotës së anëtarësimit (në qoftë se ekziston) pushon që në momentin e paraqitjes së letrës së largimit pranë Kryetarit të Bordit.

Procedura e heqjes dorë nga anëtarësia përcaktohet në rregulloren e brendshme.

### **Neni 15 – Të Drejtat e Anëtarëve**

Anëtari i Institutit ka të drejtë:

1. Të zgjedhë dhe të zgjidhet për organet drejtuese të Institutit.
2. Të marrë pjesë në mbledhjet e organeve drejtuese dhe të Asamblesë së Përgjithshme.
3. Të shprehë lirisht mendimin e tij me shkrim ose me gojë në organet drejtuese të Institutit për mbarëvajtjen dhe administrimin e saj.
4. T'ua drejtohet për çështje vetjake dhe të Institutit organeve drejtuese të saj.
5. Të marrë pjesë në veprimtaritë e Institutit në përputhje me statutin.
6. Të kërkojë nga organet drejtuese të Institutit ndihmën dhe informacionin e nevojshëm si dhe të njihet me aktivitetet që organizohen.
7. Të marrë pjesë në të gjitha mbledhjet që trajtojnë çështje që kanë lidhje të drejtpërdrejtë me personin e tij.
8. Të bëjë propozime dhe sugjerime për veprimtarinë e Institutit dhe t'ia paraqesë Bordit Drejtues të Institutit.
9. Të heqë dorë nga pjesëmarrja në Institut kur ta shohë të arsyeshme.
10. Të shpërblehet për kontributin e dhënë në favor të Institutit dhe të rimbursohet për shpenzimet e kryera në favor të Institutit, në qoftë se një gjë e tillë bëhet e mundur nga gjendja financiare e Institutit.
11. Të informohet vazhdimisht mbi zhvillimet e reja në Institut dhe në fushën e Auditimi të Brendshëm .

## **Neni 16 – Detyrat e Anëtarëve**

Anëtari i Institutit ka këto detyra:

1. Të respektojë dhe të zbatojë me seriozitet dhe disiplinë maksimale statutin, vendimet, rregulloret, urdhëresat e aktet e tjera që rregullojnë jetën e brendshme të strukturave të Institutit.
2. Të marrë pjesë, kur i kërkohet, në aktivitetet që organizon Instituti.
3. Të ndihmojë Institutin për realizimin e misionit të saj.
4. Të mbrojë dhe promovojë veprimtarinë e Institutit.
5. Të marrë pjesë rregullisht në mbledhjet e organeve të Institutit.
6. Të mbajë pastër figurën e tij morale për të mos dëmtuar autoritetin dhe personalitetin e Institutit.
7. Të paguajë kuotën vjetore brenda afatit të përcaktuar në rregullore.
8. Në të gjithë veprimtarinë e tij, të veprojë në përputhje me normat ligjore të shtetit shqiptar.
9. Të japë propozimet përkatëse me shkrim në varësi të çështjes që do të shtrohet për diskutim përpara zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme.

## **Neni 17 – Përfundimi i Anëtarësisë**

Anëtarësia përfundon kur anëtari vdeslargohet ose përjashtohet .

## **Neni 18 – Përjashtimi nga Instituti ose organet drejtuese**

Përjashtimi nga Instituti kryhet sipas dispozitave për masat disiplinore të parashikuara në këtë statut dhe në rregulloren e brendshme të funksionimit të Institutit. Vendimi merret me shumicë votash nga Bordi Drejtues mbi propozimin e Komitetit të Etikës, pasi t'i jetë dhënë anëtarit e drejta e shprehjes së arsyeve të tij mbështetëse. Njoftimi i takimit për diskutimin mbi çështjen dhe motivimin e vendimit ndëshkues, i duhen komunikuar anëtarit nga Sekretariati të paktën 30 ditë përpara zhvillimit të takimit. Megjithatë, në rast veprimesh të qëllimshme të anëtarit, Bordi drejtues mund ta përjashtojë anëtarin pa nevojën e mbledhjes paraprake. Njoftimi dhe arsyetimi i vendimit ndëshkues i komunikohen me shkrim anëtarit nga kryetari i Bordit drejtues.

Mospagimi i detyrimeve të anëtarësisë brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e brendshme të funksionimit të Institutitë, përbën shkak për përjashtim nga anëtarësia. Në këtë rast humbja e anëtarësisë hyn në fuqi 30 ditë nga data e njoftimit të anëtarit nga Sekretariati i Institutit.

Sidoqoftë, ndërprerja e anëtarësimin nga Instituti nuk i jep ish-anëtarit asnjë të drejtë rimbursimi të kuotave të anëtarësimin të derdhura pranë Institutit.

Mosparaqitja tri herë radhazi për shkaqe të paarsyeshme në mbledhje të organeve drejtuese përbën shkak për përjashtimin e anëtarit nga organet drejtuese.

### **Neni 19 - Masat Disiplinore ndaj anëtarëve**

Bordi Drejtues mund të vendosë masa disiplinore kundrejt anëtarëve të Institutit, nëse ata veprojnë në kundërshtim me Statutin apo me parimet themelore të Institutit.

Një anëtar mund t'i hiqet me afat kohor ose përgjithmonë e drejta e anëtarësisë (të përjashtohet) ose e drejta e ushtrimit të funksioneve drejtuese në Institut, të parashikuara në Statut, kur ai me dashje shkel Statutin e Institutit, kur shkel rëndë parimet themelore të Institutit apo kur kryen veprime apo shfaq ose manifeston çfarëdolloj qëndrimi i cili dëmton Institutit.

Masat disiplinore janë:

1. Vërejtje.
2. Pezullimi i përkohshëm (me afat të caktuar) i së drejtës për të qenë anëtar apo për të mbajtur funksione drejtuese.
3. Heqja e funksioneve në Institut.
4. Heqja e së drejtës për të qenë anëtar i Institutit.

Masa disiplinore motivohet me shkrim nga ana e Bordit Drejtues dhe një kopje e vendimit i jepet anëtarit. Masat disiplinore jepen në përputhje me veprimet e kryera nga anëtarët. Heqja e së drejtës për të qenë anëtar i Institutit miratohet nga Asambleja e Përgjithshme. Deri në marrjen e këtij vendimi, anëtarësia mbetet e pezulluar.

Procedurat në lidhje me masat disiplinore përcaktohen në Rregulloren e Brendshme të Funksionimit të Institutit.

Kundër vendimit, anëtar mund të ushtrojë ankim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë brenda 7 ditësh pas vënies në dijeni lidhur me këtë vendim.

### **Neni 20 - Qëndrime që dëmtojnë Institutin**

Qëndrimet që dëmtojnë Institutin janë:

1. Abuzimi me pasurinë materiale, emrin e mirë dhe reputacionin e Institutit.
2. Përkatësia në një organizëm tjetër që është haptazi në konflikt interesash dhe dëmton aktivitetin apo imazhin e Institutit.
3. Veprime të cilat vetë anëtarit, kur ka detyrë në funksione drejtuese, i kryen pa marrë miratimin e organeve eprore etj.
4. Pozicionimi publik a privat kundër Objektivave, Qëllimeve dhe aktiviteteve të shpallura të Institutit.
5. Dhënia/shpërndarja e paautorizuar e informacioneve konfidenciale të Institutit.



## **KREU III**

### **STRUKTURA E BRENDSHME**

#### **DHE FUNKSIONIMI I INSTITUTIT**

##### **Neni 21 – Struktura e brendshme dhe funksionimi i Institutit**

Instituti do të ketë strukturat e brendshme të mëposhtme:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Bordi Drejtues;
- Kryetari i Bordit;

##### **Neni 22 – E Drejta e Përfaqësimit**

Kryetari i Bordit i Institutit ka të drejtën të përfaqësojë Institutin në marrëdhëniet me të tretët. Kjo e drejtë është e delegueshme dhe mund t'i delegohet çdo anëtar i Institutit me anë të një dokumenti të firmosur nga vetë Kryetari i Bordit.

##### **Neni 23 – Asambleja e Përgjithshme**

Organi më i lartë vendimmarrës i Institutit është Asambleja e Përgjithshme e cila mbledhet të paktën 2 herë në vit në mbledhjen e zakonshme të saj.

Vendimin për mbledhjen e Asamblesë e merr Kryetari i Bordit, Bordi Drejtues ose  $\frac{1}{4}$  e anëtarëve të Asamblesë.

Vendi, data dhe ora e axhendës ditore të Asamblesë vendosen nga Bordi drejtues dhe komunikohen me shkrim, nëpërmjet faksit, postës elektronike apo nëpërmjet mjeteve të tjera që sigurojnë provën e marrjes së njoftimit. Në njoftimin për mbledhjen, i cili duhet dërguar të paktën 30 ditë para datës së vendosur për mbledhjen e Asamblesë, duhen specifikuar gjithashtu edhe vendi, data dhe ora e mbledhjes së dytë, e cila nuk mund të kryhet brenda të njëjtës ditë të caktuar për mbledhjen e parë, por sidoqoftë jo më parë se 3 ditë nga data e fiksuar për mbledhjen e parë. Në rastet e një Asambleje të Jashtëzakonshme, njoftimi dhe mbledhja bëhen sipas të njëjtës procedurë.

##### **Neni 24 – Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme**

Kompetencat e Asamblesë së Përgjithshme janë si më poshtë:

1. Mbikëqyr dhe kontrollon aktivitetin e Bordit Drejtues;
2. Analizon dhe miraton raportet financiare;
3. Përcakton veprimet strategjike dhe plan-veprimin e Bordit Drejtues dhe cakton veprimet prioritare;
4. Miraton plan-buxhetin për periudhën e ardhshme financiare;
5. Shqyrton dhe vendos për kërkesat e bëra nga anëtarët për sa i përket aktiviteteve ose angazhimeve që duhet të përfshihen në planin e veprimit të Institutit;

6. Merr vendimin për emërimin, riemërimin apo shkarkimin (pezullimin) e anëtarëve e Bordit Drejtues me një shumicë prej së paku 2/3 e anëtarëve të saj;
7. Merr vendimin për emërimin, riemërimin apo shkarkimin e Kryetarit të Bordit me 2/3 e anëtarëve të saj.
8. Miraton statutin ose ndryshimet e tij me një shumicë prej së paku 3/5 e anëtarëve të saj;
9. Miraton rregulloret e brendshme të Institutit.

## **Neni 25 – Përbërja e Asamblesë**

Mbledhjet e Asamblesë drejtohen nga Kryetari i Bordit dhe, në mungesë të tij, nga zv. Kryetari i Bordit ose ne mungesë të këtij të fundit, nga një person i caktuar nga Asambleja e Përgjithshme.

Një Asamble që të konsiderohet e rregullt, në kushte të zakonshme aktiviteti, në mbledhjen e saj të parë përbëhet nga prezenca personale apo e deleguar e të paktën 50+1 anëtarëve, ndërsa në mbledhjen e saj të dytë konsiderohet e rregullt cilido qoftë numri i anëtarëve personalisht prezent apo të deleguar. Delegimi mund t'i jepet i shkruar, vetëm një tjetër anëtar të Institutit; çdo anëtar mund të jetë i deleguar i maksimumi 8 anëtarëve të tjerë të Institutit.

Një Asamble që të konsiderohet e rregullt, në kushte të jashtëzakonshme aktiviteti, në mbledhjen e saj të parë përbëhet nga prezenca personale apo e deleguar e të paktën 1/3 e anëtarëve, ndërsa në mbledhjen e saj të dytë konsiderohet e rregullt cilido qoftë numri i anëtarëve personalisht prezent apo të deleguar.

Ndërhyrja në Asamble mund të realizohet edhe nëpërmjet mjeteve të telekomunikacionit që i lejojnë të gjithë pjesëmarrësve të komunikojnë dhe ndërveprojnë me të tjerët.

Në çdo mbledhje mbahet një procesverbal, i cili në fund nënshkruhet nga mbajtësi i procesverbalit dhe Kryetari i Bordit ose drejtuesi i mbledhjes. Një kopje e procesverbalit, pas përpilimit të tij, u jepet për lexim anëtarëve për të paraqitur pretendimet e tyre në lidhje me të dhe, nëse ka, ato evidentohen në një aneks të veçantë. Pasi u shpërndahet anëtarëve të Asamblesë procesverbali, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicë votash për miratimin e tij.

Një kopje e procesverbalit të Asamblesë së Përgjithshme, pas miratimit nga Asambleja, u komunikohet me adresë elektronike ose adrese postare të gjithë anëtarëve.

## **Neni 26 – Vendimmarrja**

Asambleja e Përgjithshme merr vendimet me 50% + 1 të pjesëmarrësve votues, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë statut. Vendimet e marra nga Asambleja e Përgjithshme nënshkruhen nga Kryetari i Bordit të Institutit . Ato mund të nënshkruhen edhe nga drejtuesi i mbledhjes por, në çdo rast, duhet të firmosen edhe nga Kryetari i Bordit në një moment të dytë.

## **Neni 27 – Mbledhjet e Jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme**

Asambleja e Përgjithshme mund të mbledhet edhe në raste të posaçme, për shqyrtimin e çështjeve të rëndësisë së veçantë në kompetencë të saj për të cilat nuk mund të pritet mbledhja e radhës e Asamblesë së Përgjithshme.

Kjo Asamble mbledhet kur e kërkojnë Bordi Drejtues, Kryetari i Bordit apo  $\frac{1}{4}$  e anëtarëve të Asamblesë. Në rastin konkret, Bordi Drejtues njofton brenda dy javësh datën e mbledhjes dhe rendin e ditës.

Për mbajtjen dhe miratimin e procesverbaleve zbatohet e njëjta procedurë e parashikuar në nenin 25 të këtij statuti.

## **Neni 28 - E Drejta e Nismës Vendimmarrëse**

Të drejtën për t'i bërë kërkesa dhe propozime Asamblesë së Përgjithshme e kanë:

- a. Kryetari i Bordit;
- b. Bordi Drejtues;
- c. Jo më pak se 10% e anëtarëve;

Kërkesat për rendin e ditës dhe kandidaturat që do të votohen duhen depozituar pranë Bordit Drejtues të paktën 15 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Kërkesat dhe kandidaturat e paraqitura pas këtij afati mund të pranohen vetëm pas miratimit të Bordit Drejtues, vetëm në qoftë se ka pasur arsye të motivuara për mosparaqitjen e kërkesës apo nëse kërkesa është e një rëndësie të madhe.

Kërkesat e paraqitura edhe një herë pas rrëzimit të tyre nuk pranohen nga Bordi Drejtues dhe nuk i kalojnë Asamblesë së Përgjithshme për shqyrtim.

## **Neni 29 – Bordi Drejtues: përbërja dhe përgjegjësitë**

Bordi Drejtues përbëhet nga 7 (shtatë) persona midis të cilëve Kryetari, Zëvendës Kryetari, Sekretari i Përgjithshëm dhe anëtarët e tjerë. Janë gjithashtu pjesë e Bordit drejtues, ata anëtarë me të drejtë vote si:

- Kryetari i fundit i Bordit Drejtues, paraardhës i kryetarit aktual
  - Kryetari i nderit.
2. Bordi drejtues gëzon të drejtën t'i propozojë Asamblesë dhënien e statusit kryetar nderi një anëtar të vetëm të shoqatës që dallon në mënyrë të veçantë për aftësitë profesionale dhe që ka kontribuar në mënyrë të dukshme në rritjen dhe zhvillimin e shoqatës. Në rast aprovimi, kryetari i nderit bëhet anëtar me të drejta të plota i Bordit Drejtues me kohëzgjatje të pacaktuar.
  3. Bordi Drejtues ka për detyrë përcaktimin e politikave dhe strategjive të Institutit, me qëllim përmbushjen e objektivit social të vendosur nga ky statut dhe nga Asambleja e anëtarëve, me përjashtim të detyrave që ligji dhe ky statut i rezervojnë Asamblesë apo organeve të tjera.
  4. Kompetencat ekskluzive të Bordit drejtues janë:

- Formulimi i strategjive të përgjithshme të shoqatës dhe verifikimi periodik i realizimit të projekteve strategjike të miratuara;
  - Hartimi i bilancit vjetor dhe i raportit shoqërues mbi drejtimin me qëllim prezantimin për miratim Asamblesë;
  - Hartimi i modifikimeve të mundshme në statut, me qëllim prezantimin për miratim Asamblesë;
  - Aprovimi i rregulloreve për ngritjen e komiteteve dhe për funksionimin e tyre;
  - Aprovimi i delegimeve specifike të anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv, me propozim të Kryetarit;
  - Aprovimi i buxhetit (versionin fillestar dhe buxhetin e modifikuar në vazhdimësi), me të drejtën e përcaktimit të shkallës së agregimit apo detajimit të çdo zëri të bilancit;
  - Administrimi i procedurave të riemërimit dhe të votimit të anëtarëve të rinj të një komiteti nga anëtarët ekzistues;
  - Emërimi (dhënia e detyrave) i Sekretarit të Përgjithshëm;
  - Caktimi i detyrave të veçanta anëtarëve të shoqatës.
5. Bordi Drejtues miraton rregulloren ku përcaktohen mënyrat e funksionimit të Shoqatës, kushtet për pranimin e anëtarëve, mbledhjen e kuotave të anëtarësisë dhe çdo normë tjetër të nevojshme për përmbushjen e qëllimeve të Shoqatës.

### **Neni 30 – Mandati dhe shpërblimi**

Mandati i rregullt i secilit prej anëtarëve të Bordit Drejtues është 4 vjet, me të drejtë riemërimi. Ai vazhdon deri në fund të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, e cila kryen zgjedhjen e anëtarëve të tjerë të Bordit Drejtues.

Në rast vdekjeje, dorëheqjeje, largimi apo përjashtimi të njërit prej anëtarëve të Bordit Drejtues, anëtari me vota më të larta në zgjedhjet paraardhëse në të cilat janë zgjedhur anëtarët e Bordit Drejtues, hyn automatikisht në Bordin Drejtues, detyrë të cilën ai do ta kryejë deri në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë së Përgjithshme.

Anëtarët e Bordit Drejtues e ushtrojnë veprimtarinë e tyre në mënyrë vullnetare. Anëtarët e Bordit Drejtues nuk kanë të drejtë të përfitojnë asnjë lloj page për përmbushjen e detyrave që i cakton një funksion të tillë. Këta anëtarë gëzojnë të drejtën e rimbursimit të shpenzimeve që janë kryer gjatë përmbushjes së detyrave të caktuara, nëpërmjet miratimit paraprak nga Bordi Drejtues, i cili informon për njohjen e këtyre shpenzimeve në raportin shoqërues të bilancit (pasqyrave finaciare). Gjithmonë nëpërmjet miratimit paraprak nga Bordi Drejtues dhe me detyrimin e informimit mbi këto shpërblime në raportin shoqërues të bilancit, mundësia e shpërblimit të anëtarëve të Bordit Drejtues ekziston vetëm në rastet kur këta anëtarë kanë përmbushur projekte, detyra dhe përgjegjësi që nuk lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe specifike me përgjegjësinë e tyre si anëtarë Bordi.

## **Neni 32 – Vendimmarrja**

Vendimet e Bordit Drejtues merren me shumicë të thjeshtë kur nuk parashikohet ndryshe në këtë statut.

Vendimet janë të vlefshme kur miratohen me të paktën nga 50% +1 e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje apo të anëtarëve të pranishëm dhe që kanë votuar Bordit Drejtues, përveç rasteve kur në statut kërkohet përcaktimi i një shumice të cilësuar. Në këtë rast, vendimi është i vlefshëm në qoftë se votojnë të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues.

Rastet e pamundësisë së marrjes së vendimeve rregullohen sipas procedurave të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Institutit.

Gjatë mbledhjeve të Bordit Drejtues mbahet një procesverbal, i cili në fund nënshkruhet nga mbajtësi i procesverbalit dhe Kryetari i Bordit. Në mungesë të Kryetarit të Bordit, procesverbali nënshkruhet nga një anëtar i Bordit të cilit i është deleguar kompetenca nga Kryetari i Bordit.

## **Neni 33 –Zgjedhja e Kryetarit të Bordit**

Zgjedhja e Kryetari i Bordit bëhet me të paktën 2/3 e votave të anëtarëve të Asamblesë së Përgjithshme të pranishëm në mbledhje. Në qoftë se kjo shumicë nuk arrihet, atëherë zhvillohet një mbledhje e dytë e Asamblesë së Përgjithshme.

Në qoftë se edhe pas këtij votimi nuk arrihet shumica e kërkuar, atëherë zgjedhja bëhet me 50% + 1 të votave. Kryetari i Bordit, në bashkëpunim me Bordin Drejtues, organizon mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për zgjedhjen e Bordit të ri Drejtues. Organizimi i kësaj mbledhjeje duhet bërë sa më shpejt që të jetë e mundur dhe jo më vonë se një muaj nga zgjedhja e Kryetari i Bordit.

Për arsye të justifikuara, mbledhja mund të bëhet edhe pas kalimit të afatit njëmuajor. Kryetari i Bordit paraqet një raport të veçantë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme për të arsyetuar vonesën e mbledhjes. Në rast se kjo vonesë është e pajustificuar, ndaj tij mund të merren masa disiplinore. Në rast se nga mosmbledhja e Asamblesë së Përgjithshme është shkaktuar ndonjë dëm, atëherë lind e drejta për dëmshpërblim, sipas Kodit Civil.

## **Neni 34 – Kryetari i Bordit**

Kryetari i Bordit të Institutit është Stavri Pashko Kryetari i Bordit zgjidhet për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjidhjeje deri në 2 herë.

## **Neni 35 – Të Drejtat dhe Detyrat e Kryetari të Bordit.**

Kryetari i Bordit kujdeset për mbarëvajtjen e punëve në Institut. Kryetari i Bordit ka këto të drejta dhe detyra :

1. Merr në shqyrtim kërkesat për pranimin e anëtarëve të rinj në organizatë;

2. Është përgjegjës për përfaqësimin e Institutit me palët e treta;
3. Miraton projekt-programin e aktiviteteve vjetore, plan-veprimet dhe projekt-buxhetin përkatës që i propozohet dhe ia prezanton Asamblesë së Përgjithshme për miratim. Ai mund të asistohet nga punonjës të Sektorëve të veçantë;
4. Administron projektet dhe programet dhe identifikon e cakton përgjegjësit, koordinatorët, aktivistët e pjesëmarrësit e tjerë në to, sipas kushteve të parashikuara në rregulloren e brendshme të funksionimit të Institutit;
5. Grumbullon informacion dhe rekomandime të nevojshme për realizimin e objektivave të Institutit dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së tij;
6. Bashkëpunon me organizma të tjerë vendas dhe të huaj;
7. Mbledh Asamblesë së Përgjithshme sipas grafikut të pranuar në takimin pararendës, duke marrë masat për shpërndarjen e dokumentacionit që do të diskutohet në takim;
8. Mund të thërrasë takime të jashtëzakonshme të Asamblesë së Përgjithshme për arsye shumë urgjente;
9. Mbikëqyr punën e sektorëve të tjerë të Institutit;
10. Emëron dhe shkarkon nga detyra punonjësit e sektorëve të Institutit pasi merr paraprakisht pëlqimin e shkruar të anëtarëve të Bordit Drejtues;
11. Drejton veprimtarinë e Bordit Drejtues dhe është përgjegjës për transparencën e vendimeve të marra nga Bordit Drejtues;
12. Thërret, përgatit dhe drejton mbledhjet e Bordit Drejtues;
13. Koordinon takimet me Bordin Drejtues dhe raporton rendin e ditës për shqyrtim;
14. Mban marrëdhënie të drejtpërdrejta me sektorët e tjerë;
15. Koordinon veprimtarinë e Sektorëve të tjerë;
16. Kryen detyra të tjera të përcaktuara në statut.

### **Neni 36 – Sekretari i Përgjithshëm**

Sekretari i Përgjithshëm duhet të përmbushë detyrat që i ka caktuar Bordi Drejtues. Libri i anëtarëve të regjistruar, Librat kontabël dhe libri i procesverbaleve të Asambleve të anëtarëve dhe mbledhjeve të Bordit Drejtues, ruhen dhe administrohen në përgjegjësinë e drejtëpërdrejtë dhe të plotë të tij. Sekretari i Përgjithshëm duhet të hartojë raportet e kërkuara nga Bordi Drejtues dhe të përmbushë çdo detyrë tjetër që i përket normalisht një Sekretari të Përgjithshëm për të mbajtur vazhdimisht të informuar Bordin Drejtues, Komitetin Ekzekutiv dhe anëtarët e shoqatës. Duhet të sigurojë komunikimet e parashikuara për thirrjen e Asambleve, të sigurojë publikimin e bilancit (pasqyrave financiare), si dhe përmbushjen e detyrimeve ligjore dhe fiskale të shoqatës.

## **KREU IV**

### **TË ARDHURAT E INSTITUTIT DHE ADMINISTRIMI I TYRE**

#### **Neni 37 – Të ardhurat e Institutit.**

Të ardhurat e Institutit do të sigurohen konform legjislacionit ne fuqi nga:

1. Kuotat e anëtarësisë.
2. Të ardhura dhe financime nga donatorë të ndryshëm, qofshin ata lokalë apo dhe ndërkombëtarë.
3. Dhurata, asistenca dhe programe të financuara nga shoqata ndërkombëtare, vendase dhe fondacionet e huaja e të tjerë.
4. Të ardhura të siguruara nga vetë aktiviteti i Institutit.

#### **Neni 38 – Administrimi i të ardhurave**

Rregullat dhe metodat për administrimin financiar të të ardhurave do të përcaktohen në një rregullore të posaçme miratuar nga më shumë se gjysma e anëtarëve të Bordit Drejtues.

Të ardhurat e Institutit përdoren nga organet drejtuese në përputhje me rregulloren përkatëse të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme me qëllim për t'i shërbyer objektivave të Institutit.

Bordi Drejtues ka për detyrë të jetë transparent për të gjitha vendimeve të marra.

## **KREU V**

### **SHPËRNDARJA DHE LIKUIDIMI I INSTITUTIT**

#### **Neni 39 – Shpërndarja e Institutit**

Shpërndarja e Institutit bëhet:

- a. Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të thirrur vetëm për këtë qëllim dhe me miratimin e 3/5 të anëtarëve të Institutit.
- b. Kur numri i anëtarëve të Institutit arrin nën numrin e caktuar në ligj.
- c. Kur qëllimi i Institutit është përmbushur.
- d. Kur Instituti nuk ka mundësi të përmbushë qëllimin e tij.
- e. Me vendimin e gjykatës kompetente pasi ky vendim merr formë të prerë.

#### **Neni 40– Likuidimi i Institutit**

Bordi Drejtues do të kërkojë likuidimin e Institutit në takimin e Asamblesë së Përgjithshme dhe ai kontrollon dhe aprovon procedurat përfundimtare të likuidimit ose mbylljes së Institutit. Me caktimin e likuidatorit /likuidatorëve përfundojnë funksionet e Kryetari i Bordit dhe të Bordit Drejtues.

Asambleja e Përgjithshme ka të drejtën e caktimit të likuidatorit ose likuidatorëve.

Vendimi merret me kuorumin e  $\frac{3}{4}$  të votave të të gjithë anëtarëve të pranishëm.

#### **Neni 41 – Prezantimi i raportit financiar që pason likuidimin**

Brenda dy muajve pas caktimit të tij/tyre, likuidatori/likuidatorët kërkojnë një mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme për të prezantuar situatën financiare dhe kërkojnë një raport të situatës për procedurën e mbylljes.

#### **Neni 42 – Të Drejtat dhe Detyrat e Likuidatorit**

Likuidatori përfaqëson Institutit dhe ka kompetencat profesionale për procedurat e likuidimit. Ai/Ajo është i/e autorizuar të paguajë të gjithë kreditorët.

#### **Neni 43 – Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve dhe ndërmjet tyre dhe organeve të tjera zgjidhen me mirëkuptim dhe në përputhje me statutin dhe rregullat e Institutit.

Në qoftë se nuk arrihet që këto mosmarrëveshje të zgjidhen brenda strukturave të Institutit me mirëkuptim reciprok, atëherë secili prej anëtarëve mund të kërkojë që ato të zgjidhen në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **KREU VI**

#### **DISPOZITAT TRANZITORE DHE TË FUNDIT**

#### **Neni 46 – Vazhdimësia e organeve ekzistuese.**

Ngarkohet Asambleja e Përgjithshme të caktojë anëtarët e rinj të Bordit Drejtues si dhe Kryetarin i Bordit të ri të Institutit.

**Ky Statut përgatitet në 5 kopje origjinale, në gjuhën shqipe. Anëtarët kanë rënë dakord për përmbajtjen e tij dhe zotohen ta zbatojnë atë me besnikëri.**